

**Parku Kombëtar i Lumit Vjosa
Konsultimi me palët e interesuara**

Raporti përfundimtar

Prill 2024

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Ekskursion në terren dhe fushata me fletëpalosje
3. Takime konsultimi me palët e interesuara
 - a. Rezultate
4. Dialogu i konsultimit me palët e interesuara
 - a. Intervistat e hapura
 - i. Rezultate
 - b. Anketa në internet
 - i. Rezultate
 - c. Matrica e palëve të interesuara
5. Konkluzione të përgjithshme dhe rekomandime

1. Hyrje

Konsultimi me palët e interesuara u ideua për të kuptuar perceptimet e komuniteteve vendore dhe të aktorëve kryesorë në lidhje me Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (PKLEV) dhe për të siguruar realisht marrjen parasysh të interesave të tyre brenda Planit të ardhshëm të Menaxhimit të Integruar (PMI).

Proceset e konsultimit me palët e interesuara janë në thelb të dyanshme; dhe ndërkohë që dëgjonim edhe po ndanim. Synimi ynë ishte të shkonim përtej 'marrjes së informacionit', të motivonim palët e interesuara që të marrin një rol më aktiv në menaxhimin afatgjatë të parkut. Në këtë drejtim, procesi i konsultimit me palët e interesuara mori një dimension komunikimi në emër të parkut. Këndvështrimet që dolën nga ai funksion i dyfishtë janë përshkruar gjithashtu në të gjithë raportin.

Për të mbledhur dhe shpërndarë informacion në të njëjtën kohë, konsultimi me palët e interesuara u nda në tre faza të njëpasnjëshme secila me formatin e vet të konsultimit, me a) Fushata me fletëpalosje të kombinuara me intervista të hapura me palët e interesuara për të vendosur temat që do të ndihmonin në organizimin e b.) takimeve të strukturuar me palët e interesuara; ku të gjitha këto do të përfshiheshin më pas në pyetjet c) e anketës përfundimtare që u zhvillua në internet.

a) Leaflet Campaign



b) Stakeholder Workshops



c) Survey

Këto tre formate prodhuan informacion të dobishëm për perceptimet dhe pozicionet e palëve të interesuara të ndara në 24 sektorë që mund të ndahen sipas moshës, gjinisë dhe sektorit. Rezultatet dhe përfundimet janë më poshtë.

2. Ekskursion në terren dhe fushatë me fletëpalosje

Faza e parë e konsultimit me palët e interesuara u ideua si një ekskursion në terren në të gjithë luginën për të krijuar raporte me sa më shumë komunitete dhe individë, për t'i informuar ata për zhvillimet më të fundit në procesin e planifikimit të parkut, duke përfshirë ftesën për të marrë pjesë në raundin e parë të takimeve të konsultimit—dhe për të dëgjuar perceptimet e tyre për krijimin e parkut.

Mungesa e informacionit dhe dekadat e mosbesimit të qeverisë i ngarkon grupet e punës së ekspertëve me gjetjen e mënyrave të reja për t'u lidhur me njerëzit dhe për të krijuar besim në procesin e krijimit të parkut.

Dy ekskursione në terren në zonën e Vjosës u zhvilluan në gusht 2023 në mbi 80 fshatra dhe qytete për të arritur përfaqësimin sa më të gjerë të mundshëm të palëve të interesuara.

3. Takime konsultimi me palët e interesuara

Katër seminare u zhvilluan në Përmet, Gjirokastrë, Tepelenë dhe Vlorë në ditë të njëpasnjëshme. Rreth 135 palë të interesuara morën pjesë në seminare.¹ Të tetë sektorët kryesorë të palëve të interesuara u përfaqësuan në seminare sipas identifikimit që bëri ekipi i konsultimit me palët e interesuara: Palët e interesuara institucionale Lokale dhe Qendrore, Komunitetet Lokale, Aktivistët, Industria, Arsimi dhe Kërkimi; Historia dhe Kultura; Media dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Objektivat e takimeve të konsultimit me palët e interesuara

Aktivitetet e Angazhimit të Palëve të Interesuara janë ideuar:

- për të komunikuar objektivat e kësaj faze të punës për krijimin e parkut – ku kemi qenë dhe ku po shkojmë – duke theksuar konceptin e “një parku në zhvillim”
- për të krijuar raporte dhe për të mbledhur kontakte për të patur një linjë të hapur komunikimi me palët e interesuara nga të gjithë sektorët.
- për të theksuar të dëgjuarin – ekspertët duhet të dëgjojnë nga palët e interesuara, jo anasjelltas.
- për të kuptuar specifikat dhe problemet lokale dhe për të identifikuar pengesat midis objektivave të konservimit dhe zhvillimit.
- për t'u fokusuar në dhënien e një panorame të qartë për ekspertët e PMI-së mbi situatat ku mund të lindin konflikte gjatë zbatimit të turizmit brenda parkut kombëtar.
- për të vlerësuar dhe analizuar pozicionet e palëve të interesuara dhe për të përgatitur rekomandime për PMI-në.

Konkluzionet kryesore nga takimet e konsultimit me palët e interesuara që ndikojnë në planin e menaxhimit

Presioni i turizmit dhe ndikimi në mjedis:	Qëndrimi pozitiv ndaj mbrojtjes:	Infrastruktura dhe zhvillimi:
<p>-Rritja e turizmit po çon në stres mbi burimet dhe rritje të mbetjeve, veçanërisht në Gjirokastrë.</p> <p>-Roli i kufizuar i lumit në identitetin e Gjirokastrës.</p> <p>-Shqetësime për zonat e përmytura dhe kompleksiteti i monitorimit nga AdZM.</p>	<p>-Qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj mbrojtjes dhe kufizimeve në aktivitete.</p> <p>-Angazhimi dhe interesimi turistik për planet e interpretimit dhe vendndodhjen e qendrave të vizitorëve.</p>	<p>-Nevojat imediate për vaditje dhe furnizim me ujë, veçanërisht në Tepelenë.</p> <p>-Çështje të vazhdueshme me pompat private të vaditjeve dhe infrastrukturën bashkiake/publike.</p> <p>-Projekte intensive të vazhdueshme zhvillimi në Vlorë, duke përfshirë aeroportin, qytetin dhe bregdetin.</p>

¹ Lista nuk është e plotë për Vlorën ku ishin të pranishëm mbi 40 persona, por lista e pjesëmarrësve u firmos vetëm nga 28 persona.

Konflikte dhe rrugë të paqarta drejt zgjidhjeve:	Vlera e rekreacionit dhe shqetësimet e sigurisë:	Shqetësime dhe projekte mjedisore:
<p>-Konflikt për nxjerrjen e ujit në Luginën e Shushicës dhe ndërtimin e një projekti për nxjerrjen e ujit në afërsi të HEC-it të Kalivaçit;</p> <p>-Konflikt për projektin e aeroportit në lagunën e Nartës, zonë e mbrojtur;</p> <p>-Pasiguri për zgjidhjen e kontratave ekzistuese në zonat e përdorimit të qëndrueshëm, si rasti i Mallakastrës;</p>	<p>-Njohja në nivel universal e vlerës së lartë rekreative të lumit, duke përfshirë aktivitete si noti, kampingjet në natyrë dhe rafting.</p> <p>-Nevoja për vende të dedikuara noti për arsye sigurie.</p> <p>-Distanca e paqartë e zonës tampon për ndërtim nga shtrati i lumit që çon në interpretime të ndryshme nga komunat.</p>	<p>-Shqetësime për kultivimin e peshkut dhe ndikimin negativ të tij në ekosistemin lumor.</p> <p>-Nevoja për planifikim për të adresuar inputet dhe menaxhimin e troftës ylber.</p> <p>Probleme të përgjithshme të sistemit të ujërave të zeza në Tepelenë.</p> <p>Projekte të ndryshme në vazhdim paralelisht, sidomos Vita Vjosa, rehabilitimi dhe pastrimi i shtigjeve.</p>

4. Dialogu i konsultimit me palët e interesuara

a) Intervistat e hapura

35 persona u intervistuan përgjatë qershorit, gushtit dhe shtatorit 2023. Intervistat u zhvilluan ballë për ballë me sektorë të ndryshëm të interesit, nga drejtuesit e komunitetit (“kryeplak”), te banorët dhe operatorët e biznesit, me objektivin për të mbledhur ndjesitë cilësore për PKLEV që do të jepnin informacion për takimet me palët e interesuara dhe që më vonë do të shërbenin për përgatitjen e anketës në internet.

Bisedat ishin joformale, me kohëzgjatje të ndryshme dhe miqësore, në përpjekje për të krijuar shoqëri dhe për të minimizuar shtrembërimin e ndjesisë së të intervistuarve. Të intervistuarit u njohën me qëllimin e procesit të angazhimit të palëve të interesuara, rëndësinë e tij dhe rolin e ekipit kërkimor. Atyre iu kërkua të diskutojnë marrëdhënien e tyre me lumin, çfarë mundësish mund të shohin ose jo me krijimin e parkut dhe çfarë pasojash mund të parashikojnë në jetën e tyre të përditshme për shkak të kalimit të lumit në një status të mbrojtur të lumit.

i. Rezultate

Pas përfundimit të intervistave, konsulentët krijuan pesë kategori të ndjesive.

Aleatë aktiv 31% - Të përfshirë në mënyrë aktive me kauzën e lumit; ndërveprim të përditshëm dhe përfaqësim në emër të lumit në ndërveprim me bashkëmoshatarë / kolegë / institucione; në gjendje të shohin përtej përfitimeve personale për kauzën më të madhe të mbrojtjes dhe konservimit të lumit.

Mbështetës institucional 34% - Të përfshirë në kauzën e lumit për shkak të rolit të tyre institucional; mbështetin kauzën emocionalisht në nivel personal, por këndvështrimi i të tyre ndikohet nga të qenit punonjës; kanë tendencë të shohin PKLEV si të pashmangshëm dhe me optimizëm.

Pozitivë 21% - Jo të përfshirë drejtpërdrejt me kauzën e lumit; mbështetin kauzën e konservimit dhe mbrojtjes si pjesë e përmirësimit të turizmit, që është industria e tyre, ndoshta sipërfaqësorë për shkak të mungesës së informacionit dhe prirjen të kenë qëndrimin "presim e shohim".

Ambivalentë 11% - Të papërfshirë dhe të largët nga kauza që zakonisht rrjedh nga mungesa e besimit tek institucionet. Për rrjedhojë e shohin PKLEV si një projekt të destinuar për dështim; nuk dëshirojnë të përfshihen zyrtarisht në kauzë, por do ta mbështesin përfundimisht nëse projekti do të ishte i suksesshëm.

Kundër 3% - Aktivisht kundër krijimit të parkut; e shohin atë si kufizim ndaj aktiviteteve ekonomike, të ardhurave dhe frenues të mjeteve të jetesës në komunitetet e tyre ose të të tjerëve.

Përmbledhje e gjetjeve nga intervistat

Intervistat e hapura shpalosin informacion mbi këndvështrimet e palëve të interesuara në lidhje me krijimin dhe menaxhimin e Parkut Kombëtar të Vjosës. Ndërsa ka një mbështetje të konsiderueshme për krijimin e parkut në 86%, palët e interesuara theksojnë një sërë sfidash dhe konsideratash që duhet të adresohen.

- **Komunikime:** 74% e njerëzve të intervistuar përmendin mungesën e informacionit që komunikohet – dhe si rrjedhojë mungesën e transparencës – si problem. Kjo prek si autoritetet lokale ashtu edhe anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga mënyra e jetesës. Përfaqësuesit e pushtetit vendor ndihen të pa informuar. Pronarëve të bizneseve lokale dhe anëtarëve të komunitetit u mungon informacioni me të cilin mund të marrin vendime ekonomike për veten e tyre në lidhje me kufizimet e ardhshme dhe ambientalistët janë skeptikë për qeverisjen e ardhshme të parkut.
- **Shqetësime mjedisore:** 54% e njerëzve të intervistuar theksojnë sfidat mjedisore si ndotja, degradimi i habitatit dhe humbja e biodiversitetit si çështje të rëndësishme që duhen adresuar përmes krijimit dhe menaxhimit të parkut. 31% gjithashtu ngrenë çështje bujqësore, vaditjeje dhe menaxhimi të tokës, të cilat më pas zhvillohen në probleme jetese për të gjithë degën e Shushicës (përfaqësues institucionalë dhe drejtues lokalë). Kjo përfshin gjithashtu shqetësimet në lidhje me përmytjet dhe çështjet e menaxhimit të ujit dhe ndikimin e mundshëm të parkut në praktikata e fermave familjare; siç është nevoja për skema të përditësuar të vaditjes dhe ndërgjegjësimi për ruajtjen e tokës dhe përdorimin e plehrave. Kjo del edhe në dialogun me autoritetet lokale dhe ambientalistët e shqetësuar për mospërputhshmërinë e objektivave të turizmit me konservimin.

- **Sfida ekonomike:** 34% e të anketuarve kanë shqetësime për ndikimet e mundshme ekonomike, duke përfshirë ndryshimet në mjetet tradicionale të jetesës, aksesin në burime dhe zhvillimin e lidhur me turizmin kur ekzistojnë kufizime.
- **Frika nga shpërngulja:** 34% e të anketuarve, të cilët ishin të gjithë nga Lugina e Shushicës, ngrenë shqetësime ekzistenciale rreth shpërnguljes ose zhdukjes së komuniteteve për shkak të konflikteve mbi menaxhimin e burimeve.

b) Anketa në internet

Anketa në internet me palët e interesuara mori përgjigje nga 382 persona nga 11 zona, duke siguruar një përfaqësim të larmishëm sipas moshës, gjinisë dhe sektorëve me pjesëmarrje që varion nga nën 17 deri në 65 vjeç e lart. Shumica e dukshme e moshave të të anketuarve (49%) i takonte grupmoshës 31-49.

Një çekulibër në përfaqësimin gjinor është gjithashtu i dukshëm, me shumicën e të anketuarve gra (63%) dhe (36%) burra. Besojmë se kjo ndodh për faktin se një nga grupet më të mëdha të të anketuarve ishte nga institucionet arsimore publike si Universiteti i Vlorës dhe i Gjirokastrës; si dhe mësuesit dhe nxënësit e shkollave të mesme (të kontaktuar nëpërmjet prindërve) ishin kryesisht gra.

Larmia e përfaqësimit institucional sugjeron gjithashtu një përgjegjësi të përbashkët për konservimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pellgut të lumit Vjosa, me aktorë të ndryshëm që pranojnë nevojën për përpjekje të koordinuara dhe bashkëpunim për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore.

Normat më të larta të pjesëmarrjes sektoriale ishin mes vizitorëve ose grupeve të interesuara (29%), anëtarëve të komunitetit (23%) dhe institucioneve (15%). Këto grupe treguan një përkushtim të madh për të formuar drejtimin e projektit dhe për të siguruar përafrimin e tij me nevojat dhe interesat lokale. Akademia dhe subjektet kërkimore (12.7%) kontribuan me ekspertizë të vlefshme, ndërsa industrinë (12.2%) ofruan njohuri mbi pasojat dhe pritshmëritë ekonomike. Aktivistët e mjedisit ose përfaqësuesit e shoqërisë civile (3.7%) janë fuqishëm në favor të ruajtjes së mjedisit.

Më poshtë diskutojmë temat kryesore që dolën nga përgjigjet.

i. Rezultate

Ndërgjegjësimi për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa

96% e të anketuarve janë në dijeni të krijimit të PKLEV. Kjo tregon suksesin e fushatave të komunikimit rreth krijimit të parkut. Mediat sociale ishin kanali më i spikatur (79%), i ndjekur ngushtësisht nga televizioni (69%). Duhet të theksohet se mediat sociale, televizioni dhe media të tjera që mund të kenë qenë përpjekje të udhëhequra nga qeveria nuk janë të dallueshme në këtë anketë. Vetëm 14% e njerëzve pohuan se komunikimi i qeverisë ishte burimi i tyre kryesor i informacionit.

Në përgjithësi, është një gjetje pozitive, por zbulon se megjithëse qeveria ka zgjedhur kanale si media sociale dhe televizioni për të komunikuar informacion rreth parkut, palët e interesuara nuk janë të vetëdijshme për qëllimin dhe kjo mund të jetë një mundësi e humbur.

Niveli i perceptuar i informacionit dhe i pranimit të parkut

Përderisa shumica e të anketuarve shprehen se ndihen të informuar mjaftueshëm për qëllimet dhe planet e ardhshme për Parkun Kombëtar (58%), pothuajse gjysma ndihen ende të painformuar mjaftueshëm. Ata që ndihen të informuar mjaftueshëm i përkasin të anketuarve institucionale. Operatorët e biznesit në të gjitha industritë, aktivistët mjedisorë dhe anëtarët e komunitetit raportojnë se ndihen të informuar ose të painformuar në numër të barabartë.

Praktikisht nuk kishte asnjë ndjesi negative të shprehur në këtë pyetje. Të anketuarit janë në mbështetje të krijimit të parkut, por 42% raportojnë nevojën për të pasur më shumë informacion rreth parkut. Kjo përputhet me gjetjet në intervistat e hapura me palët e interesuara.

Një i anketuar i jashtëzakonshëm u shpreh se ishte i vendosur kundër krijimit të parkut për shkak të pritshmërisë se do të pengonte turizmin. Kjo pikëpamje ndoshta përfaqëson një ndjesi më të përhapur për shkak të mungesës së informacionit, por që nuk është regjistruar nga anketa.

Një sfidë kryesore e anketës është se njerëzit që janë apatikë ose kundër parkut kanë shumë më pak gjasa të shpenzojnë kohë për të plotësuar anketën. E njëjta çështje u ngrit gjatë intervistave ku ekipi kërkimor mund të mos jetë konsideruar mjaftueshëm i besueshëm për të dhënë informacion negativ ndaj qeverisë, duke e bërë angazhimin të duket si humbje kohe. Për të luftuar këtë paragjykim, ne iu drejtuam drejtpërdrejt disa përfaqësuesve të industrisë, të njohur nga kërkimet e mëparshme për mendimin "kundër" që t'i pyesnim për pikëpamjet e tyre. Dy të anketuar të synuar qëllimisht nga industria e minierave ishin në mbështetje të plotë të krijimit të parkut, dhe njëri raportoi se qeveria i kishte dhënë informacion në lidhje me kufizimet.

Njerëzit që i janë përgjigjur kësaj ankete në përgjithësi kanë pritshmëri shumë të larta për zhvillimin ekonomik dhe turistik në luginë si rezultat i drejtpërdrejtë të krijimit të parkut. Por në të njëjtën kohë ata kanë njohuri të pamjaftueshme mbi kufizimet që do të vendosen ndaj aktiviteteve. Kjo situatë mund të kuptohet si një lloj pozicioni "presim e shohim": dakordësi me premisën bazë të një lumi të mbrojtur, por me një kuptim të kufizuar të ndikimit personal në të ardhmen.

Perspektivat e palëve të interesuara mbi përfitimet ekonomike dhe mjedisore

Përfaqësuesit e industrisë janë grupi që raporton pritshmëritë më të larta të përfitimit nga Parku Kombëtar mes 73% të të gjithë të anketuarve. Të tre grupet e shohin turizmin si shtytësin kryesor të përfitimeve ekonomike në të ardhmen në luginë.

26% e të anketuarve reflektojnë skepticizëm në lidhje me zbatimin e masave të konservimit që do të rrisin vlerën e parkut të cilin ata e shohin si jetik për përfitimin ekonomik që do të pasojë.

Shumica e njerëzve të anketuar përmendin që vlera e ardhshme ekonomike në luginë është e varur nga mbrojtja dhe konservimi, duke mos e parë këtë të fundit si përjashtim të zhvillimit të turizmit. Kjo pasqyron një mundësi të madhe për avancimin e planit të menaxhimit.

81% e të gjithë të anketuarve besojnë se parku do të përmirësojë mjedisin natyror të luginës. Kjo ndjesi ndahet midis industrisë, institucioneve dhe sektorëve . Pothuajse të gjithë të anketuarit (99%) presin që

ndryshimi i statusit të parkut të ndikojë në mbrojtjen e tij dhe si rrjedhojë të përmirësohet mjedisi natyror i parkut.

Po kështu, pothuajse të gjithë të anketuarit presin që PKLEV të ndikojë pozitivisht në vendin në tërësi.

93% e përfaqësuesve institucionale presin që parku të jetë pozitiv për Shqipërinë në tërësi, duke reflektuar qartë vizionin dhe angazhimin institucional të qeverisë për krijimin e parkut.

Një person i anketuar e sheh avantazhin e krijimit të një modeli fari për vendin “Vjosa do të jetë shembull për lumenjtë e tjerë”.

Skepticizmi për aftësinë ose vullnetin e qeverisë për të mbrojtur lumin ishte i pranishëm në rezultatet e anketës ku një i anketuar komentoi: “Nëse zbatohet siç synohet në të vërtetë (dhe jo thjesht një shfaqje e rreme propagandistike) do të ndihmojë për të mbrojtur/konservuar natyrën për shkak të rregullave dhe rregulloreve, por madje edhe për "valorizimin" e natyrës. Në të njëjtën kohë, krijimi i një parku natyror do ta bëjë atë më tërheqës për turizmin, pra më shumë vizitorë, gjë që përsëri do të rrisë presionin (potencial) mbi natyrën. Pra, është një panoramë e përzier.”

Perceptimi i sfidave dhe rreziqeve

66% e të anketuarve nuk mendojnë se parku përbën kërcënim apo sfidë për punën, jetesën apo jetën e tyre të përditshme. Kjo reflekton edhe pritshmëritë e tyre se parku në përgjithësi është një zhvillim pozitiv për vendin. Është interesante që pozicionet drejtuese të nivelit të lartë janë ato që parashikojnë më shumë rreziqe dhe sfida me krijimin e Parkut Kombëtar, kundrejt joprofesionistëve dhe sektorëve të biznesit që kryesisht nuk e perceptojnë parkun si rrezik.

Përfaqësuesit e industrisë janë të ndarë mes përfitimeve që rrjedhin nga zhvillimi i turizmit dhe sfidave që sjell nevoja për rritjen e masave mbrojtëse për të akomoduar të njëjtin zhvillim turizmi.

Në grupin sektorial, sfidat dhe rreziqet parashikohen nga ekspertë dhe profesionistë të cilët janë më afër kauzës së parkut kombëtar dhe kanë njohuri më të thella mbi pasojat, problemet dhe sfidat reale me të cilat përballen në të gjithë luginën. Studentët, të rinjtë dhe vendasit që e lidhin jetesën e tyre me turizmit apo zhvillimin ekonomik kanë perspektivën e zhvillimeve të dobishme që do të sjellë parku.

Komunikimet

Gjetjet e anketës pasqyrojnë një nivel të konsiderueshëm ndërgjegjësimit dhe interesi për krijimin e Parkut Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa. Ndërkohë që janë bërë përpjekje për të informuar publikun, mbetet nevoja për angazhim dhe komunikim të vazhdueshëm për të siguruar gjithëpërfshirje dhe transparencë.

93% e të anketuarve raportojnë se nuk iu është drejtuar ndonjë autoritet për të diskutuar kufizimet e aktiviteteve brenda parkut. (një numër i madh i të anketuarve e kanë anashkaluar këtë pyetje ose kanë raportuar N/A në grupin e synuar të përfaqësuesve industrialë dhe sektorialë).


Megjithëse qindra njerëz u kontaktuan si pjesë e këtij projekti, me disa takime që u mbajtën me anëtarët e komunitetit përpara anketës, niveli i kontaktit nuk i afrohet asaj që palët e interesuara presin pothuajse një vit pas krijimit të parkut.

Më tej, kontakti me të gjithë sektorët e palëve të interesuara duhet të vendoset në mënyrë strategjike, duke shfrytëzuar kanale të shumta komunikimi. Kjo do të nxisë mirëkuptimin dhe mbështetjen më të madhe për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemit të lumit Vjosa.

Komentet e palëve të interesuara përkojnë me gjetjet nga ekskursionet në terren dhe intervistat ballë për ballë. Natyra e shqetësimeve të shprehura është: Transparenca dhe përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në komunikim dhe proces; shqetësimet mjedisore duke përfshirë përpjekjet për rigjenerim dhe në të njëjtën kohë ndotja dhe menaxhimi i mbetjeve dhe sjelljet dëmtoese; shqetësimet për sundimin e ligjit dhe efektivitetin e funksionimit dhe qeverisjes së parkut; përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit duke përfshirë edukimin e palëve të interesuara dhe brezave të rinj.

Matrica e palëve të interesuara

Hartëzimi i palëve të interesuara të adresuara në këtë studim sipas nivelit të ndikimit dhe nivelit të interesit.



5. Konkluzionet e përgjithshme mbi ndjesitë për PKLEV

Statusi i Parkut Kombëtar mbështetet gjerësisht si ide, ndërsa realiteti i tij mbetet relativisht i panjohur.

Parku u krijua me një nxitim të paparë për të ndaluar ndërtimin e digave. Rreth gjysma (56%) e njerëzve të anketuar *mbështesin fuqishëm* mbrojtjen e zonës si park, ndërsa 42% e mbështesin, por kanë nevojë të dinë më shumë. Ka të ngjarë që shumica e mbështetësve të parkut sot të jenë në fakt thjesht mbështetës për ndalimin e ndërtimit të digave. Dhe megjithëse do të duhen ende shumë vite që parku të shihet si një lloj territori i ndryshëm nga ai që ishte, një vizion i qartë dhe bindës për atë që qeveria *synon* do të ndihmonte shumë në sigurimin e mbështetjes.

Rreziku i të panjohurës

Parku i ri dhe ajo që përfaqëson është e mirëpritur, por edhe pse mbështetja është e përhapur, për shumë sektorë kjo mund të ndodhë vetëm sepse njerëzit nuk e dinë se çfarë do të thotë në të vërtetë për ta. Një përfaqësues i industrisë nga një kompani e shisheve të ujit u përgjigj pa asnjë negativitet dhe tha thjesht "ne jemi të interesuar të dimë më shumë". Rreziku këtu për planin e menaxhimit është se ka shumë sektorë që ende nuk janë të kërcënuar, por kur të kërcënohen, ata mund të kthehen shpejt në një qëndrim "kundër" dhe të bëhen pengesë për mbrojtjen.

Pavarësisht mungesës së informacionit, shumica e njerëzve janë optimistë për atë që parku mund të jetë

Megjithëse 40% e njerëzve nuk ndihen të informuar mjaftueshëm, 73% besojnë se parku do të jetë një përfitim ekonomik për ta ose për zonën, dhe 99% e të anketuarve mendojnë se krijimi i parkut do të ndihmojë në përmirësimin e mjedisit. Ky optimizëm shtrihet edhe tek të rinjtë, me 84% që parashikojnë se mbrojtja e parkut do të sjellë përfitime ekonomike për zonën.

Ekziston një oreks i përhapur për veprim individual

Bledar Mullara ka një restorant mes Tepelenës dhe Kelcyrës. Ai u intervistua në gusht dhe shpjegoi përpjekjet e tij personale për pyllëzimin në brigjet e lumenjve pranë restorantit të tij. Përfaqësuesit e AdZM-së e dinë më mirë se kushdo se zbatimi i ligjeve brenda parkut vetëm nga nëpunësit e shtetit do të jetë i pamundur. Të gjithë kanë një farë detyre për të mbrojtur ekosistemet, qoftë duke denoncuar shkelësit, duke krijuar një grup vullnetarësh për të mbledhur mbeturinat, apo duke ndërgjegjësuar miqtë dhe familjen tuaj. Informacioni i plotë, i rregullt dhe i përditësuar i qeverisë për atë që lejohet dhe nuk lejohet, ku dhe sa, i fuqizon njerëzit për të ndihmuar në përpjekjet e mbrojtjes.

Fëmijët dhe të rinjtë luajnë një rol të rëndësishëm

Perceptimet e të rinjve ngjajnë kryesisht me ato të të rriturve. Njësoj me optimizmin ekonomik dhe mbështetjen e tyre për parkun, në intervista, të rinjtë kanë një pasion dhe energji ngjitëse për të bërë ndryshime. Në shumë raste gjatë anketës ata treguan gjithashtu besimin e vërtetë tek institucionet që i bënë ata një pasuri të vlefshme për të ardhmen e parkut. Kur u pyetën "Pse mendoni se mjedisi do të përmirësohet?" një person nën moshën 17 vjeç komentoi "Duke qenë një Park Kombëtar, ai nuk mund të ndotet më dhe do të bëhet një vend më i qëndrueshëm".

Qëndrimi "Presim e shohim" ka avantazhet e veta

96% e të anketuarve janë të vetëdijshëm se parku ekziston, ndërsa 40% ndihen jo mjaftueshëm të informuar për qëllimet e tij. Vakuumi i informacionit i lë pronat dhe pronarët e bizneseve veçanërisht pa

mjetet që u nevojiten për të vepruar me maturi, duke krijuar një ngrirje. Në intervista, palët e interesuara përsërisin se në të vërtetë nuk bëhet fjalë për të qenë "pro" ose "kundër" parkut, ata thjesht duan të dinë se si të vazhdojnë me pasurinë e tyre.

Kjo pauzë përpara se të miratohet PMI dhe mekanizmat e tij të zbatimit është gjë e mirë për shëndetin e ekosistemit të lumit, pavarësisht se nuk është shkak për zhgënjim për palët e interesuara.

Koncepti i një marrëdhënieje simbioze mes një lumi të pastër dhe vlerës së turizmit është kuptuar mirë

Shumica e të anketuarve përmendin se vlera e ardhshme ekonomike në luginë është e ndërvarur nga konservimi, duke mos e parë këtë të fundit si të tillë që përjashton zhvillimin e turizmit. Një i anketuar tha "Së pari do të përmirësojë ekosistemin dhe së dyti do të sjellë shumë vizitorë vendas dhe të huaj". Një tjetër u shpreh se "si operatorë në fushën e turizmit dhe agroturizmit, ne mendojmë që shpallja e Vjosës park kombëtar do të sjellë avantazhe në këtë sektor, gjithashtu shpresojmë për një mjedis dhe lumë më të pastër për vizitorët dhe të ftuarit që vijnë për natyrë dhe sporte ujore! Zona ka vlera të paçmuara natyrore, historiko-kulturore, tradicionale-zakonore, produkte dhe gatime tipike etj., të cilat do të njihen edhe më shumë nën statusin e Parkut Kombëtar. Të gjitha këto mund të përkthehen në ekonomi të qëndrueshme, e cila tashmë ka filluar të japë rezultatet e para të dukshme prej më se një viti." Kjo paraqet një mundësi të madhe për qeverinë që të zhvillojë në mënyrë proaktive një politikë të zhvillimit të qëndrueshëm që do të përshpejtojë zhvillimin gradual dhe do të zhdukë ndërtimet e stilit të turizmit masiv.

Parku i lidhur me ndjenjën më të madhe të patriotizmit

91% e të anketuarve e shohin "padyshim" krijimin e parkut kombëtar si arritje pozitive për Shqipërinë në përgjithësi. Shumë njerëz e lidhin vendimin për mbrojtjen e parkut me patriotizmin për bukuritë natyrore të vendit, duke komentuar se "Vjosa do të jetë shembull për lumenjtë e tjerë". Të tjerë shkojnë aq larg sa e interpretojnë si pjesë të procesit të krijimit të shtetit të së drejtës. Një i anketuar tha se "nuk do t'i shërbejë më interesave personale të një grupi të vogël njerëzish". Regjimi i mbrojtjes së lumit kuptohet edhe si ngritje e standardeve të zhvillimit të vendit në përputhje me ato të BE-së: "Shpallja e parkut kombëtar do të thotë më shumë vëmendje ndaj mbrojtjes së parkut, më shumë promovim dhe më shumë projekte zhvillimi sipas standardeve europiane."

Mungesa e Burimeve për Mbrojtje dhe Zbatim ndihet nga Autoritetet Vendore

Përfaqësuesit e autoriteteve vendore përsëritën nevojën për të pasur informacion të përditësuar dhe të plotë për kufijtë e parkut dhe zonat, veçanërisht nisur nga konflikti i dukshëm me kontratat ekzistuese dhe parcelat e tokës në pronësi private.

Rekomandime:

- **Përkuluni përpara një "Parku në krijim"**

Ky koncept funksionon. Një rrezik në shpalljen e një parku kombëtar përpara se të vendoset sinjalistika fizike dhe regjimet e mbrojtjes është që turistët të zhgënjohen nga ajo që gjejnë dhe të shkaktojnë dëm reputacioni në internet. Në verën e vitit 2023 qarkulluan video të shumta në tiktok të turistëve që humbisnin në sheshet e ndërtimit të papërfunduara në bregdetin shqiptar. Në intervista, një i anketuar i kërkoi qeverisë "të shmangë krijimin e një 'parku të rremë' dhe bashkë me të edhe reputacionin e Shqipërisë si destinacion 'mos shkoni atje se kanë ndërtuar kudo në natyrë hotele, resorte rrugë etj, është shkatërruar! [...]" "Një park në krijim" është një mënyrë elegante për të shpjeguar një situatë shumë të ndërlikuar që gjen mirëkuptim si nga

banorët ashtu edhe nga turistët. Jepuni vizitorëve kontekstin e idesë dhe bëjeni atë të dukshëm në luginë. Do të largojë negativitetin dhe do të tërheqë njerëzit në procesin historik të parkut.

- **Artikuloni një vizion për parkun që njerëzit ta mbështesin**

Përdorni konkursin e arkitekturës si bazë për komunikimin e këtij vizioni. Shumica e vlerave të ndërtimit mund të përputhen me vlerat e parkut dhe do të gjejnë mirëkuptimin nga njerëzit, sepse ato janë të dukshme dhe të orientuara drejt së ardhmes. Një nga shkrimtarët e mëdhenj shqiptarë të Rilindjes, Naim Frashëri, u rrit në Vjosë dhe ngjallte patriotizmin përmes bukurisë së peizazhit. Me anë të këtij parku është krijuar një gjurmë në plan e të ardhmes së jetës rurale shqiptare.

- **E ardhmja e parkut do të ketë nevojë për njerëz të rregullt për të ndihmuar në mbrojtjen e tij. Filloni ta krijoni atë ndjenjë detyre tani duke qenë dorëlëshuar me informacionin.**

Informacioni fuqizon qytetarët konservatorë. Informacioni i plotë, i rregullt dhe i përditësuar i qeverisë për atë që lejohet dhe nuk lejohet, ku dhe sa, i fuqizon njerëzit të ndihmojnë në përpjekjet për mbrojtje.

- **Vazhdoni të flisni, jini të pranishëm, jini të arritshëm**

Qeveria duhet të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me palët e interesuara për të adresuar sfidat dhe shqetësimet e përbashkëta në një forum të qëndrueshëm dhe transparent. Kjo do të përmirësojë besimin institucional dhe në të njëjtën kohë do të forcojë aleancën dhe do të rrisë mbështetjen nga aktorët e papërfshirë.

- **Ndërtoni parkun me jo për**

Askujt nuk i pëlqen që ndryshimi t'u ngarkohet atyre. Zbatoni qasje gjithëpërfshirëse të menaxhimit që përfshijnë palët e interesuara nga të gjithë sektorët, duke përfshirë turizmin, bujqësinë, industrinë dhe qeverinë, dhe komunitetet lokale. Në përgjithësi, palët e interesuara që kanë qenë më të angazhuara në dialog janë në të njëjtën kohë më të vetëdijshme për atë që pason me statusin e ri të lumit dhe gjithashtu mbështesin projektin përtej përfitimeve personale.

- **Angazhoni fëmijët dhe të rinjtë**

Fëmijët duan të bëjnë diçka. Lidhjet e fëmijëve me botën natyrore formohen më lehtë dhe në mënyrë më të qëndrueshme sa më të rinj që të jenë ata. Por pasi të formohen, ato zgjasin një jetë. Krijoni programe shkolle që në kopsht duke sjellë shkollat e zonës rregullisht në lumë. Vendoseni atë në kurrikulën e shkencës. Dhe mbështesni shkollat për të rritur shoqatat e studentëve që të zhvillojnë aktivitete ndërgjegjësimi dhe konservimi të habitatit.

- **Mbani burimet e autoriteteve lokale**

Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të pajisen me burime, kapacitete dhe financa për të synuar çështjet që ndikojnë në jetesën e njerëzve në PKLEV. Këto strategji do të siguronin përafrimin e qëllimeve të niveleve të ndryshme qeveritare me përpjekjet e konservimit dhe menaxhimit, dhe do të bënin një tranzicion më të lehtë drejt nivelit të përgjithshëm maksimal të mbrojtjes duke siguruar mbështetjen lokale.

- **Mendoni afatgjatë, veproni afatshkurtër**

Frustrimet e përditshme e bëjnë të lehtë të harrohet që ekosistemi i parkut do të zgjasë shumë shekuj nëse kujdesi për të është i mirë. Sfidat me të cilat përballemi duhet të merren gradualisht

duke shikuar drejt horizonteve afatgjata. Një i anketuar i qeverisë, kur u pyet nëse mendonte se parku përbënte rrezik apo sfidë për punën e tij, u përgjigj thjesht po, "por ia vlen (!)"